

VENDIM
Nr.442, datë 16.6.2011

PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE TË DOKUMENTEVE VËRTETUESE TË AFATEVE TË VLEFSHMËRISË DHE TË PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE PËR AUTORIZIMIN E TREGTIMIT TË MINERALEVE TË ÇMUARA DHE GJYSMË TË ÇMUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32 pika 2, e 56 pika 1 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për kryerjen e tregtimit të mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara, personat juridikë, vendas dhe të huaj, të regjistruar si të tillë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), duhet të pajisen me autorizimin përkatës.

2. Dhënia e autorizimit të tregtimit të mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara personave juridikë bëhet nga ministri përgjegjës për veprimtaritë minerare në përputhje me kërkesat e nenit 32 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”.

3. Autorizimi për tregtimin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara jepet me afat vlefshmërie deri në 10 (dhjetë) vjet nga data e hyrjes në fuqi, me të drejtë deri në 2 (dy) vjet, me kusht që kjo shtyrje afati të kërkohej nga zotëruesi i autorizimit të paktën 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike para përfundimit të afatit të vlefshmërisë.

4. Dokumentacioni i plotë i kërkesës për autorizim për tregtimin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara paraqitet në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN). Data e aplikimit shpallet në *web site-in* e këtij institucioni.

5. Dokumentacioni i plotë i kërkesës për autorizim për tregtimin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara, i cili shqyrtohet dhe vlerësohet nga AKBN-ja, duhet të përmbajë:

a) ekstraktin e vendimit të QKR-së për regjistrimin, si person juridik, ku në objektin e veprimtarisë të këtij të miratuar edhe zhvillimin e aktivitetit të tregtimit të mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara sipas kërkesës;

b) një përshkrim të kapaciteteve profesionale dhe menaxheriale të kërkuarit që i vlejnjë atij për realizimin e veprimtarisë së tregtimit të mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara, si dhe një përshkrim të përvojës së tij të mëparshme në këtë fushë, nëse ka;

c) të dhëna për burimet financiare të nevojshme për realizimin e kësaj veprimtarie;

ç) specifikim të mineralit/mineraleve për të cilat kërkohej autorizimi;

d) një informacion për tregjet e mundshme të shitjes së këtyre mineraleve dhe për kontratat paraprake të lidhura për këtë qëllim, nëse ka;

dh) vërtetimin nga organet përkatëse që nuk është fajtor për asnjë vepër penale, cilësuar si e tillë pas një procesi të plotë gjyqësor, që lidhet me veprimtarinë e tregtimit të mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara. Për shoqëritë e huaja, një vërtetim të tillë nga vendi i origjinës.

6. AKBN-ja pasi e shqyrton dhe vlerëson dokumentacionin e plotë për autorizimin për tregtimin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara, por jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike pas marrjes së aplikimit, e dërgon atë në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), së bashku me mendimin me shkrim për dhënien ose jo të autorizimit, të nënshkruar nga titullari i saj.

7. Ministri, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e aplikimit në AKBN, nxjerr aktin e dhënies ose të mosdhënies së autorizimit për tregtimin e mineraleve të çmuara dhe gjysmë të çmuara. Në këtë rast, nuk zbatohet parimi i miratimit në heshtje. Forma e autorizimit përcaktohet në rregulloren që miratohet nga ministri.

8. Kërkuarisi njoftohet për miratimin ose jo të kërkesës me shkrim nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës dhe nëpërmjet publikimit në *web site-n* e saj.

9. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha